




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC  
OF KOSOVA KOMUNA E  
SUHAREKËS OPSTINE SUVA  
REKA THE MUNICIPALITY OF



30-12-2024

REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA E SUHAREKËS		REPUBLIKA KOSOVA - OPSTINA SUVA REKA	
THE REPUBLIC OF KOSOVO - THE MUNICIPALITY OF SUHAREKË			
M-PRILAVENI		M-PRILAVENI-RECEIVED	
Njësia org. Org. Je. Org. Ue.	Titulli Posti	Shtesa Faqja Appendix	Vlera Vendnost Value
01	05270687	f	

# PLANI I PUNËS PËR VITIN 2025

Të dashur bashkëqytetarë,

Unë, Bali Muharremaj, kryetar i Komunës së Suharekës, ju siguroj se barazia para ligjit, transparencja dhe llogaridhënia do të jenë shtyllat kryesore të qeverisjes tonë edhe gjatë vitit 2025. Vizioni ynë mbetet që të punojmë për interesin dhe mirëqenien e qytetarëve, duke adresuar sfidat dhe duke zhvilluar potencialet që ekzistojnë në komunën tonë.

Viti 2025 paraqet një mundësi të re për të përmbushur pritshmëritë e qytetarëve, për të vazhduar me realizimin e projekteve që e kanë transformuar komunën tonë dhe për të implementuar nisma të reja që e afrojnë komunën me standardet më të larta të zhvillimit dhe progresit. Ky plan është bazuar në nevojat dhe prioritetet që kanë ngritur qytetarët, duke përfshirë projekte konkrete të hartuar me kujdes nga ekipet tona profesionale.

Përmes këtij dokumenti, do të prezantojmë objektivat kryesore dhe fushat prioritare për secilën drejtori dhe sektor, të mbështetura nga bashkëpunimet me aktorët lokalë dhe ndërkombëtarë. Përkushtimi ynë do të jetë maksimal në çdo fushë, qoftë ajo infrastruktura, ekonomia, arsimi, shëndetësia, apo mirëqenia sociale.

Ju siguroj se plani i punës për vitin 2025 është përgatitur me vizion të qartë dhe përgjegjësi të lartë, duke reflektuar aspiratat dhe kërkesat e qytetarëve tanë. Bashkë, do të realizojmë më shumë projekte dhe do të ndërtojmë një të ardhme më të ndritur për komunitetin tonë.

Me respekt,

Bali Muharremaj

## DREJTORIA PËR BUJQËSI ZHVILLIM RURAL DHE PYLLTARI

<b>Janar</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Zbatimi i planeve dhe programeve për bujqësi, blegtari, bletari, turizem.</li> <li>2. Përgaditja e projekteve për bujqësi, blegtari, zhvillim rural – turizem.</li> <li>3. Takime konsultative - pune me stafin e drejtorisë.</li> <li>4. Organizimi i trajnimeve për fermer.</li> <li>5. Shqyrtimi i kërkesave të fermerëve.</li> <li>6. Vizita në teren.</li> <li>7. Thirrje publike për aplikim - Sera.</li> <li>8. Thirrje publike për aplikim të fermerëve- Projekti me bashkëfinancim me organizatën Islamic Relief Kosova, Mekanizem Bujqësor.</li> </ol>	
<b>Shkurt</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Përgaditja e projekteve për tenderim: Ndërtimi i Serave, Ndërtimi Infrastruktues për Bujqësi, Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqet bujqësore në Studençan.</li> <li>2. Përgaditja e projekteve me bashkëfinancim- vazhdimi i bashkëpunimit me organizatat si IADK, Swiss Contact, dhe Islamic Relief.</li> <li>3. Pranimi i aplikacioneve për subvencione të fermerëve dhe digjitalizimi i parcelave nga AZHB.</li> <li>4. Regjistrimi i Fermerëve në EFR.</li> <li>5. Organizimi i takimeve me qëllim bashkëpunimi me OJQ për realizimin e projekteve në bujqësi, sipas marrëveshjeve.</li> <li>6. Thirrje për aplikim të fermerëve për subvencionimin e qumshtit.</li> <li>7. Hartimi i projekteve dhe konsulenc per fermeret e Komunes se Suharekës</li> </ol>	
<b>Mars</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i kanalit te lagjja “Bylykbashi” në Samadraxhë</li> <li>2. Digjitalizimi i parcelave për subvencione të fermerëve nga AZHB.</li> <li>3. Vizitë fermerëve për fituesit e projektit “Ndërtimi i Serave”</li> <li>4. Organizimi i këshillimeve për fermer me qëllim të ngritjes së kapaciteteve profesionale.</li> <li>5. Trajtimi i qeneve endacak.</li> <li>6. Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqet bujqësore, Mushtisht, Vraniq, Reshtan – projekt i Ministrisë së Bujqësisë.</li> </ol>	

<b>Prill</b>	<p>Fillimi i implementimit të projekteve.</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Ndërtimi i Serave.</li> <li>2. Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në Bujqësi dhe Pyltari– haprja e rrugeve fushore.</li> <li>3. Trajtimi i qenve emdacak.</li> <li>4. Hartimi i planit për mbjellje pranverore dhe monitorimi.</li> <li>5. Vizita në teren.</li> <li>6. Organizimi i trajnimeve me organizata të ndryshme.</li> <li>7. Digjitalizimin e parcelave për subvencionim për fermeret që aplikojnë në programin për Pagesa Direkte në AZHB per vitin 2025.</li> <li>8. Vizita në teren të fermerëve në bazë të kërkesave të tyre drejtuar Drejtorisë së Bujqësisë.</li> </ol>	
<b>Maj</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizim dhe monitorim i projekteve për kapitale të Drejtorisë së Bujqësisë</li> <li>2. Organizimi i procesit të vaksionimit për kafshë me Ambulancën Veterinare (AUVK).</li> <li>3. Vizita në teren.</li> <li>4. Realizimi i projektit: furnizimi me mekanizem bujqësor për fermerë</li> <li>5. Furnizimi me koshere të bleteve për fermerë.</li> </ol>	
<b>Qershor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Shqyrtimi i kërkesave të fermerëve të cilët aplikojnë në thirrjet publike të Drejtorisë.</li> <li>2. Vizitë në teren - monitorimi i projekteve.</li> <li>3. Pregaditja e Projektit në sektorin e Turizmit- Asfaltimi i rrugës në bjeshkë të Vraniqit faza e dytë</li> <li>4. Parapregaditje për fushatën e korrje-shirjeve – Ngritja e Shtabit për Korrje Shirje.</li> <li>5. Thirrja publike për fermeret që kanë plantacione të arrave.</li> </ol>	
<b>Korrik</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Monitorimi i korrje - shirjeve.</li> <li>2. Monitorimi i projekteve në realizim.</li> <li>3. Realizimi i projektit - rregullimi dhe ndërtimi i shtallave për bagëti.</li> <li>4. Realizimi i projekteve - zhvillimi i turizmit rural - Ndërtimi i vendkampingjeve turistike dhe sinjalizimi i shtigjeve të ecjes.</li> </ol>	
<b>Gusht</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Raporti përfundimtar për korrje – shirje.</li> <li>2. Vizita fermerëve në teren.</li> <li>3. Monitorim i projekteve gjatë realizimit.</li> </ol>	
<b>Shtator</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizim të këshillave teoriko - praktike në teren.</li> <li>2. Pregaditja për ekspozitën e produkteve bujqësore “FESTARI 2024”</li> <li>3. Shqyrtimi i kërkesave të fermerëve dhe vizita në teren.</li> <li>4. Realizimi i projektit: Ndërtimi i sistemit të ujitjes për sipërfaqet bujqësore në Studençan.</li> </ol>	

<b>Tetor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Realizim dhe monitorimi projekteve.</li> <li>2. Vizita në teren.</li> </ol>	
<b>Nëntor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Monitorimi i projekteve kapitale dhe përgaditja e raporteve në sistemin PIP-it për vitin aktual.</li> <li>2. Vizita në teren për realizimin e projekteve zhvillimore.</li> <li>3. Përgaditja e CBA për projekte të mëdha dhe futja në sistemin PIP-it 3 vjeçar.</li> </ol>	
<b>Dhjetor</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Monitorimi projekteve.</li> <li>2. Përgaditja e planit - buxhetor për bujqësi vitin 2025.</li> <li>3. Përgaditja e raporteve përfundimtare, gjatë vitit.</li> <li>4. Vizita në teren.</li> <li>5. Vlerësimi i punës së puntoreve.</li> </ol>	

## DREJTORIA PËR SHËRBIME PRONËSORE JURIDIKE GJEODEZI DHE KADASTËR

Drejtoria e Shërbimeve Pronore-Juridike dhe Kadastër , gjatë këtij do të ofroj shërbime sa më efikase për qytetarët, duke u ofruar informacione dhe të dhëna për pronat e sektorit privat dhe atij komunal.Në zyrat pritëse të dy sektorëve, sektorin e kadastrit do të mbahen takime të rregullta me qytetarët. Gjatë takimeve palëve do tu ipen këshilla për plotsimin e lëndëve sipas kërkesave të palëve. Këto kërkesa kyesisht kanë të bëjnë me bartje të trashigimis , regjistrimin ose qregjistrime të hipotekave , qirambajtje në periudh afatshkurtë 1-15 vite, dhe periudh afatgjate prej 15-99vite , kërkesa për ndarje, bashkim ose rregullim të kufijve në mes të palëve, shpronsime të pronave, këmbime (ndrrim) të pronave, uzurpime etj. Palëve ju ofrohet edhe ndihma për identifikim të pronave, sipërfaqes së pronës shfrytëzuesit aktual të pronës, si dhe historiate të parcelave të pronave private.

Në këtë vitë Shërbimi Pronsor Juridik dhe Kadastrit do të ofrojë bashkpunim të ngusht edhe me drejtoritë tjera.Me këtë plan synohet arritja e objektivave për vitin 2025, ku DSHPJK planifikon të mbaj seanca te rregullta në të cilat do te trajtohen të gjitha gështjet qe janë ne interes të Komunës dhe të qytetareve të Suharekës, e të cilat janë të proceduara sipas akteve Ligjore dhe nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës. Përveç këtyre temave të cekura DSHPJK do të shqyrtoj dhe miraton edhe tema apo çështje tjera të cilat janë me rëndësi dhe në interes për qytetarët dhe Komunën e Suharekës.Edhe këtë vit në drejtorinë tonë do të shqyrtohen me prioritet lëndët për legalizimin e objekteve.

Lista për dhrnjë në shfrytezim të pronave, të cilat planifikohen të ipen në shfrytëzim në vitin 2023, do ta publikojmë në faqe të komunës, në menyrë që qytetarët të kenë më të lehtë qasjen ose identifikimin e pronave shoqërore për t'i marrur në shfrytëzim.

- 1.** Inicimi i procedurës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës;
- 2.** Kompletimin e mungesës së stafit esencial.
- 3.** Ndarja e parcelës
- 4.** Bashkimi i parcelave
- 5.** Procesimi-rregullimit të kufirit
- 6.** Ndërrimi i kulturës,
- 7.** Ndërrimi i përdorimit të tokës,
- 8.** Regjistrimi i ndërtesës,
- 9.** Ndarja e ndërtesës,
- 10.** Bashkimi i ndërtesave,
- 11.** Fshirja e ndërtesës nga regjistri,
- 12.** Regjistrimi i pjesës së ndërtesës
- 13.** Ndarja e pjesës së ndërtesës,
- 14.** Bashkimi i pjesëve të ndërtesës,
- 15.** Fshirja e pjesës së ndërtesës nga regjistri,
- 16.** Ndryshimi i mënyrës së përdorimit të ndërtesës dhe pjesës së ndërtesës,
- 17.** Ndryshimi i llojit të drejtave dhe formave të pronësisë së pronave të paluajtshme,
- 18.** Regjistrimi i të drejtës së pronësisë,
- 19.** Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit,
- 20.** Regjistrimi i të drejtës së qirasë,
- 21.** Regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e servitutit,
- 22.** Regjistrimi, modifikimi dhe fshirja e hipotekës,
- 23.** Korrigjimin e gabimeve materiale,
- 24.** Korrigjimi/plotësimi i të dhënave për pronar/shfrytëzues dhe
- 25.** Korrigjimi i të drejtave mbi pronat e paluajtshme.
- 26.** Identifikimi i pronave të paluajtshme dhe
- 27.** Korrigjimi i gabimeve teknike.
- 28.** Shqyrtimi e kërkesave të palëve që kanë të bëjnë me bartje të trashigimis , regjistrimin ose qregjistrime të hipotekave , qirambajtje në periudh afatshkurtë 1-15 vite, dhe periudh afatgjate prej 15-99vite , kërkesa për ndarje, bashkim ose rregullim të kufijve në mes të palëve, shpronsim të pronave, këmbime (ndërrim) të pronave, uzurpime etj.
- 29.** Inicimi i procedurave për shpronësimin e pronave për interes publik, bazuar në Planin Zhvillimor Komunal, për realizimin e projekteve me interes të përgjithshëm.
- 30.** Zhvillimi i procedurave nga Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.
- 31.** Miratimi i raportit të komisionit për dhënien në shfrytëzim afatgjatë pronës së paluajtshme të Komunës;
- 32.** Raport nga Drejtoria e pronës për qiranë dhe rentën;
- 33.** Zhvillimin e procedurave për këmbimin e pronës.
- 34.** Realizimi i të hyrave në ZKK Suharek nga taksat e qytetarëve. Planifikohen rreth 120.000€-140.000€.
- 35.** DSHPK edhe këtë vitë do të shqyrtoj me prioritet kërkesat për LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE - DHE REGJISTRIMIN NË ZYRËN KOMUNALE KADASTRALE.

## DREJTORIA PËR ADMINISTRATË

### Sektori I gjendjes civile

Qëllimi kryesor	Aktiviteti	Kryerësi i punëve	Koha e realizimit
<b>1. Plotësimi, përditësimi dhe administrimi i Regjistrave të Gjendjes Civile, Mbajtja e akteve të gjendjes civile, Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile si dhe ofrimi i shërbimeve më efikase dhe më të shpejta për qytetarët. Organizimi dhe mbajtja e trajnimeve dhe aftësimi profesional i zyrtarëve të gjendjes civile. Aplikimi i sistemit Online për qytetarët.</b>	<b>1.</b> Furnizimi me regjistra të gjendjes civile dhe certifikata. Furnizimi me kompjuter dhe pajisje përcjellëse.(printer,fotokopjues, skaner,etj.) dhe furnizimi me material shpenzues për nevoja të gjendjes civile.	Udhëheqësi i sektorit të gjendjes civile në bashkëpunim me drejtorin e drejtorisë për administratë.	Janar-Mars Prill-Qershor Korrik-Shtator Tetor-Dhjetor
	<b>2.</b> Lëshimi i certifikatave dhe dokumenteve të gjendjes civile	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore
	<b>3.</b> Regjistrimi i fakteve të gjendjes civile (Lindje, Martesa,vdekje etj)	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore
	<b>4.</b> Përditësimi dhe administrimi i të dhënave të gjendjes civile në regjistrat fizik dhe në regjistrin elektronik	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore
	<b>5.</b> Kurorëzimet dhe organizimi i ceremonisë së kurorëzimeve dhe pajisja me certifikatë dhe broshurë familjare	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore
	<b>6.</b> Regjistrimi i shtetasve në regjistrin fizik dhe elektronik dhe paisja me certifikatë të shtetësisë si dhe aplikimi për natyralizim i shtetasve të huaj dhe aplikimi për humbje të shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim.	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore
	<b>7.</b> Përmirësimet dhe korrigjimet e shënimeve personale në regjistrat e gjendjes civile, ndërrimi i emrit personal dhe përcjellja e shënimeve të më vonshme dhe anë shënimeve në regjistrat e gjendjes civile.	Zyrtari i gjendjes civile	Sipas afateve ligjore

### Sektori:-Qendra për shërbime të qytetarve-ONE-STOP-SHOP

Qëllimi kryesor	Aktiviteti	Personeli përgjegjës	Afati
Lehtësues I procedurave administrative të përgjithshme komunale	Komunikimi korrekt me qytetar	Udhëheqësi I Qendrës dhe personeli ndihmës	Sipas kërkesës së palëve
	Përgatitja dhe vënja në dispozicion e broshurave informative për qytetar dhe publikimi në WEB faqe	Udhëheqësi I Qendrës në bashkpunim me zyrtarin për informim	Sipas detyrës zyrtare

Përmisues I kualitetit të shërbimeve për qytetarë Efikasitet kohor të shqyrtimit të kërkesave	Këshillimi dhe ndihma juridike për mënyrën e plotësimit të kërkesave dhe parashtresave	Zyrtarët e drejtorive përkatëse	Sipas kërkesës së palëve
	Shërbime të shpejta dhe efikase për qytetarë në të njëjtin vend kërkon zgjidhje dhe pranon edhe përgjigjen rreth kërkesës së tij. Pranimi dhe regjistrimi I kërkesave	Zyrtarët për pranimin e ankesave dhe kërkesave	Sipas kërkesës së palëve
	Shërbimi dhe asistimi I qytetarëve në një kënd me shërbime online nga sitetemi I E-Kosova	Asistenti	Sipas detyrës zyrtare

### Sektori për punë të përbashkta dhe teknologji informative

Qëllimi kryesor	Aktiviteti	Personeli përgjegjës	Afati
Avansimi në përdorimin e E-Qeverisjes.	Kujdesi për zbatimin e politikës së sigurisë së rrjetit	IT e Komunes	Sipas kontratës
	Mirmbajtja dhe ofrimi I mbështetjes për rrjetën internë të Komunës	IT e Komunes	Sipas kontratës
	Ofrimi I ndihmës së personelit të administratës komunale në përdorimin e TI.	Zyrtari për teknologji informative	Sipas kërkesës së personelit
	Mirmbajtja e TI	Zyrtari për teknologji informative	Sipas nevojës
	Furnizimi me paisje të TI. Për nevoja të administratës së Komunës	Zyrtari për teknologji informative në bashkpunim me drejtorin e Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme	Sipas nevojës
Zbatimi i Akteve ligjore për gjuhët zyrtare në Komunë	Përkthimi i dokumenteve zyrtare të Komunës		Sipas detyrës

		Zyrtari për përkthim	
Sigurimi I objektit të Komunës	Përkujdesja 24 orë për ruajtjen e objektit të Komunës dhe autoparkingut	Kompania kontraktuese	Në bazë të Kontratës
Mirmbajtja e objektit të Komunës	Mirmbajtja e higjienës në objektin e Komunës gjatë ditëve të punës	Kompania kontraktuese	Në bazë të Kontratës

#### Sektori për barazi gjinore

Aktiviteti	Departamenti të cilit i kërkohet përkrahje/bashkëpunim	Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm	Me cilin Dokumenti Strategjik është në pajtueshmëri aktiviteti në fjalë
1.1 Aktivitete informuese për promovimin e të drejtës për pushimin e lehonisë dhe prindëror	ABGJ, zyra e informimi dhe OJQ-të	Te punsuar e informuar( ne sektorin publik dhe privat) përgjatë fushates informuese 30 te punsuar	Strategjia Sektoriale e MPMS-së 2018-2022
1.2 Subvencionimi i pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetë-ushqyese, përfituese të skemave sociale	DKA dhe DSHMS perkatesisht QPS	Fëmijë të subvencionuar 2 ne vit	Plani Strategjik i Arsimit në Kosovë 2017-2021
1.3 Trajnimi i përfituesve të kategorive sociale dhe angazhimi i tyre në programet e punësimit	QPS ,Zyra e punsimit dhe QAP	Perfitues te trajnuar te kategorive sociale  10 persona	Strategjia Sektoriale e MPMS-së 2018-2022
1.4 Ndërtimi i qendrave rezidenciale dhe ditore për ofrimin e shërbimeve për personat e moshuar dhe pa përkujdesje familjare	Kryetari i Komunës dhe donatorët	Qendra ne ndertim e monitorua  1 qender	Strategjia Sektoriale e MPMS-së 2018-2022
1.5 Ngritja e kapaciteteve për vlerësimin e ndikimit gjinor në politika publike dhe legjislacion	ABGJ	Përpilues te trajnuar ne politikave publike dhe legjislacion	Ligji për Barazi Gjinore

1.6 Monitorimi i politikave ekzistuese publike (i ligjeve, udhëzimeve administrative, rregulloreve	Zyra ligjore	Akte nenligjore te harmonizuara	Ligji për Barazi Gjinore
1.7 Ngritja e pjesmarrjes se grave ne debate dhe degjime publike	GG,Kordinatori i performances dhe Zyra e informimit	Gra pjesmarrese ne degjime dhe debate publike 30 gra	Nevojë e Komunës
1.8 Sensibilizimi i grave për mundësitë e përfitimit nga Programi për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	Drejtorja e bujqësisë	Gra te paisura me njohuri per mundesit e pefitimit nga grantet ne bujqesi 20 gra	SKZH: Masa 16: Rritja e Qasjes në Financa për Ndërmarrjet Kosovare
1.9 Senzibilizimi për pjesëmarrjen e grave fermere në Shërbime Këshilluese	Drejtorja e bujqësisë	Gra pjesmarrese ne sherbime keshilluese 20 gra	SKZH: Masa 16: Rritja e Qasjes në Financa për Ndërmarrjet Kosovare
1.10 Organizimi i fushatave vetëdijësuese për të drejtën në trashëgimi dhe pronë	Abgj,Zyra e kadastrit dhe Noteret	Rritja e numrit te raseve te regjistruara si pronare dhe bashkpronare 2 fushata	SKZH:Masa 13 Forcimi i sistemit të të drejtave pronësore; Strategjia Kombëtare për të Drejtat Pronësore në Kosovë 2016-2020
1.11 Përqindja e grave në pozita vendimmarrëse (nivel drejtues dhe drejtues i lartë) në Arsim Komunal	Kryetari i Komunes dhe DKA	Perqindja me e madhe e grave ne pozita vendimmarrëse 10% te shkollave	Ligji për Barazi Gjinore
1.12 Zbatimi i pakos informuese për edukimin seksual dhe shëndetin riprodhues për shkollat fillore dhe të mesme	MASHT,DKA .DSHMS dhe shkollat	Numri i trajnimeve te realizuara me mesimdhenes	Strategjia Sektoriale e Shëndetësisë 2016-2020; Plan i Strategjik për Shëndetin e Nënës, Fëmijës dhe Shëndetin Riprodhues 2019-2021; PSAK 2017-2021
1.13 Mbajtja e aktiviteteve ndërgjegjësuese dhe vetëdijësuese mbi barazinë gjinore për	ABGJ,OJQ vendore dhe nderkombetare	Numri i aktiviteteve te realizuara 2 aktivitete	Ligji për Barazi Gjinore

grupin e grave deputete të asambleve komunale			
---	--	--	--

**Promovimi i vlerave gjinore dhe luftimi i stereotipeve gjinore.**

Aktiviteti	Departamenti të cilit i kërkohet përkrahje/bashkëpunim	Rezultati i dëshiruar/ i pritshëm	Me cilin Dokumenti Strategjik është në pajtueshmëri aktiviteti në fjalë
2.1 Shenimi i 8 marsi (dita e grave)	Nënkryetarja dhe Grupi i grave	Gra të vetedijsuara për te drejtat e tyre	Globale
2.2 Shenimi 1-3 mars ( gratë në shkencë	Nenkryetarja ,grupi i grave dhe OJQ	Gra të identifikuar me te arritura në shkencë 1 ne vit	Globale
2.3 Shenimi Muaji tetor (vetedijesim kunder kancerit te gjiut)	DSHMS	Gra te vetedisuara kunder kancerit të gjiut	Globale
2.4 Shenimi 11 tetori (Femija vajzë)	DKA	Vajza te vetdiesuara per rendesin e te qenurit vajzë	Globale
2.6 Shenimi i 25 Nentor deri 10 Dhejtor(16 Aktivizem kunder dhunes ne baza gjinore)	QKMF,QPS,PK ,OJQ vendore dhe ndërkombetare	Gra dhe vajza të vetedijësuar kunder dhunës në familje	Globale
2.7 Pjesmarrja dhe keshillimi të ndikimit gjinor(për plane dhe politika publike) te organeve komunale	ZBGJ	Organe komunale te keshilluara ne aspektin gjinor dhe plane e politika publike me ndikim gjinor	Rregullorja 12/2016

**Sektori I Arkives**

Plani vjetor për sektorin e arkivit në Komunën e Suharekës përfshin detyrat dhe përgjegjësitë që synojnë të sigurojnë menaxhimin efikas të dokumenteve në përputhje me Ligjin për Arkivat e Kosovës dhe rregulloret komunale. Ky plan mbulon mirëmbajtjen, organizimin, ruajtjen dhe dixhitalizimin e dokumenteve, si dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe administratën komunale.

**1. Objektivat Strategjike**

- Zbatimi i politikave të arkivimit: Sigurimi i përputhjes me rregulloret dhe standardet e Arkivit Shtetëror të Kosovës.
- Rritja e efikasitetit të shërbimeve: Modernizimi i proceseve të arkivimit dhe shërbimeve për përdoruesit.
- Ruajtja dhe mbrojtja e dokumenteve: Përmirësimi i kushteve fizike dhe dixhitale për ruajtjen afatgjatë të materialeve.

## 2. Detyrat dhe Aktivitetet Kryesore

### 2.1. Administrimi i Dokumenteve

- Pranimi dhe regjistrimi:
- Pranimi i dokumenteve të reja nga departamentet komunale.
- Regjistrimi dhe katalogimi i dokumenteve në regjistrat përkatës.
- Klasifikimi dhe ruajtja:
- Sistemimi i dokumenteve në hapësirat përkatëse sipas kategorive:
- Dokumente për asgjësim.

### 2.2. Mirëmbajtja dhe Organizimi i Arkivit

- Kontroll periodik.
- Azurnimi i etiketimeve dhe regjistrave fizikë.
- Përpunimi i kërkesave për qasje nga qytetarët dhe zyrtarët komunalë.
- Mbajtja e evidencës për huazimet dhe kthimet e dokumenteve.

### 2.4. Asgjësimi i Dokumenteve

- Identifikimi i dokumenteve për asgjësim:
- Rishikimi i dokumenteve të cilave u ka kaluar afati i ruajtjes (sipas ligjit).
- Përgatitja e listave dhe procesverbaleve për dokumentet që do të asgjësohen.
- Zbatimi i procesit të asgjësimit:
- Bashkëpunimi me komisionin për asgjësimin e materialeve sipas rregulloreve.

### 2.5. Dixhitalizimi i Dokumenteve

- Skanim dhe ruajtje dixhitale:
- Skanimi i dokumenteve kyçe dhe ruajtja e tyre në sisteme dixhitale të sigurta.

- Azhurnimi i bazës së të dhënave.
- Bashkëpunimi me Arkivin Shtetëror të Kosovës dhe Arkivin Rexhional në Prizren.
- Pjesëmarrja në seminare dhe aktivitete të organizuara nga Arkivi Shtetëror.

### 3. Afatet Kohore

- Janar – Mars:
- Inventarizimi i dokumenteve ekzistuese.
- Përditësimi i regjistrave dhe përgatitja e planit për vitin.
- Prill – Qershor:
- Kontrolli dhe mirëmbajtja e hapësirave të arkivimit.
- Përpunimi i dokumenteve për asgjësim.
- Korrik – Shtator:
- Dixhitalizimi i materialeve kyçe.
- Tetor – Dhjetor:
- Transferimi i dokumenteve me aftë më të vjetra se 30 vite në Arkivin Rexhional në Prizren.
- Përgatitja e raportit vjetor të punës.
- Infrastruktura:
- Hapësira e sigurt për arkivim fizik.
- Pajisje për dixhitalizim (skanerë, kompjuterë).
- Sistemet:
- Softuer për menaxhimin elektronik të dokumenteve.

### 5. Raportimi dhe Monitorimi

- Raporte tre mujore: Evidencë mbi dokumentet e arkivuara, kërkesat e trajtuara dhe aktivitetet e realizuara.
- Raporti vjetor: Paraqitja e rezultateve dhe sfidave të sektorit të arkivit për vitin kalendarik.

### Sektori i Shërbimeve publike

Gjatë vitit 2025 si zakonisht në Sektorin e Shërbime Publike do të bëhen punë të ndryshme që kanë të bëjnë me natyrën e punës së kësaj drejtorie. Disa nga punët më të rëndësishme, me të cilat jemi të angazhuar në këtë drejtori janë:

- Pranimi i kërkesave të ndryshme të qytetarëve, për rrugë, kanalizime, ujësejellës, ndriqime publike, si dhe shumë kërkesa tjera që i përkasin Drejtorisë sonë, po ashtu edhe shqyrtimi i tyre në teren me kërkesën e Drejtorit.
  - Pranimi i faturave të shpenzimeve komunale mallrave dhe shërbimeve, si dhe kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat e shpenzimeve komunale të Rrymës, Ujit, Telefonit, Mbeturinave.
  - Po ashtu kryerja dhe përgaditja e faturave për pagesat të ndryshme për mallra dhe shërbime brenda sektorit të Shërbimeve Publike Mjedis dhe Emergjencë.
  - Kontakte të shpeshta telefonike me Keds-in, Hidroregjionin, Ekoregjionin, etj, për nevojat e Komunës dhe të qytetarëve për zgjidhjen e kërkesave të tyre për mes telefonit.
  - Caktimi nëpër komisione të ndryshme për nevojat e komunës.
  - Përgaditja e kërkesave të KEDS-it, si dhe qytetarëve për pëlqimet konkrete të tyre, po ashtu edhe përgaditja e kërkesave KEDS-it për vendosjen e orë matëseve të rrymës për objektet e ndërtuara nga Komuna, si dhe ndriqimeve publike.
  - Përgaditja e kërkesave për Hidroregjionin Jugor njësisë Suharekë, për vendosjen e orë matëse të ujit për objekte për objekte të ndryshme të ndërtuara nga Komuna.
  - Realizimi i vizitave në teren për kërkesa të ndryshme (strehim, kanalizim, ujësejellës dhe infrastrukturë), por gjithmonë të koordinuara me Drejtorinë dhe në bashkëpunim si gjithmonë.
  - Lëshimi i dokumenteve për persona fizikë dhe institucione,
  - Raportimi i raporteve mujore për çdo muaj për faturat e paguara dhe të papaguara, për zyrtarin Kryesor Financiar të Drejtorisë së Financave.
  - Takime - konsultime të shpeshta me qytetar, për kërkesat dhe nevojat e tyre .
  - Takime të shpeshta me KFOR-in OSBE për nevojat e ndryshme të Komunës.
  - Përgaditja dhe planifikimi i buxhetit për çdo vit, për shpenzime Komunale dhe mallra dhe shërbime, si dhe për kërkesa të ndryshme brenda Drejtorisë etj.
  - Bashkëpunim të ndërsjellë me të gjitha sektorët e Drejtorive e në veqanti me Drejtorinë e Urbanizmit, Zyrën e Prokurimit dhe Drejtorinë e Arsimit ( DKA) e tjera , pastaj me “Hidro-regjionin Jugor” njësisë Suharekë “ Eko-regjionin “ njësisë Suharekë, KEDS-in, PTK-në etj.
- Kryerja e punëve të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë;

#### - **Menaxhimi i Mbeturinave,**

1) Mirëmbajtja e rrugëve lokale nga bora

2) Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve lokale në Komunë

Mbikëqyrja e ofrimit të shërbimeve publike lokale, duke përfshirë grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave

- Riciklimi dhe menaxhimi i mbeturinave PP1, në vitin 2025, në koordinim me DKA-në kemi menduar që ta zgjerojmë këtë nivel me të gjitha shkollat e komunës sonë.
- Do fillojmë me zgjerimin e aplikacionit, raporto brengjen tuaj në gjith teritorin e komunës sonë,

- PP4, po mendojmë që të fillojmë së implementuari taksën komunale me rritje, nëse kalon në Asamble komunale.
  - PP5, Formulimi i masave kundër hedhjes ilegale të mbeturinave të ndërtimit;
    - Gjatë procesit të ndërtimit, rinovimit ose rrënimt të objekteve, personat fizikë dhe juridikë duhet të largojnë mbeturinat që krijojnë nga hapësirat ose vendet publike
    - Mbeturinat e ndërtimit dhe rrënimt duhet të deponohen në deponinë legale, e cila është përcaktuar me vendim ligjor nga Kuvendi Komunal i Suharekës
    - Transportimi i këtyre mbeturinave bëhet nga vetë prodhuesit ose ndërmarrjet transportuese deri në pikat e grumbullimit të mbeturinave ose në deponinë e caktuar nga organi komunal etj .
  - Sipas planit të Menaxhimit të mbeturinave, do të bëjmë furnizim me komposter për shkolla dhe institucione tjera.
- Organizimi në mirëmbajtjen verore dhe dimërore të rrugëve lokale dhe në vendbanime, pastrimin e rrugëve dhe trotuareve të qytetit;
  - Mirëmbajtjen e hapësirave publike, hapësirave gjelbëruese, parqeve publike dhe varrezave të Dëshmorëve në territorin e Komunës.
  - Bashkëpunimi me kompaninë që ofron shërbime rreth grumbullimit dhe menaxhimit të mbeturinave.
  - Organizimi dhe koordinimi i punëve me kompanitë që ofrojnë shërbime për qytetarët;
  - Kontroll dhe mbikëqyrjen rreth realizimit të kontratave të ndërmarrjeve për punë të kontraktuar në shërbim;
  - Pranimin dhe dorëzimin e raporteve dhe faturave të dorëzuar nga operatorët;
  - Organizimin e regjistrimit të inventarit dhe mjeteve themelore;
  - Hapjen dhe vlerësimin e tenderëve sipas kërkesave të zyrës së prokurimit;
  - Kryerjen e pagesave në FreeBalanc, Alternativ e zyrtarit të Shpenzimeve;
  - Dalje në teren rreth shqyrtimit të Ankesave dhe kërkesave nga ana e Qytetarëve;
  - Mirëmbajtja e Intranetit të Drejtorisë rreth kërkesave;
  - Kryerja e punëve të tjera, në bazë të ligjeve të aplikueshme në kuadër të fushë veprimtarisë së Drejtorisë;

## **Sektori për Infrastrukturë**

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2025 në këtë sektor do kryhen punët dhe shërbime të cilat do të jenë të planifikuara me plan dhe program të paraparë për këtë periudhë vjetore.

Projektet Kapitale për vitin fiskal 2025 që do të realizohen sipas procedurave ligjore ku fillimisht do të inicohen procedurat e prokurimit, për zotimin e mjeteve për këto projekte ,ku sipas vlerave të parapara do të zotohen mjetet në vlera në të cilat do të alokohen sipas fondeve burimore Plani 10 BKK, Plani 21dhe Plani 22.

Gjatë këtij viti do të kryhen punët dhe shërbime si në vijim:

Përgaditja e kërkesave për zotim të mjeteve

Menaxhimi i projekteve

Përgjigje në kërkesa të ndryshme për institucionet e ndryshme

Komision për vlerësimin e tenderëve

Komision profesional me aktvendim të Kryetarit të Komunës,

Përgatitje të raporteve në kuadër të drejtorisë si dhe procedimi i lëndëve për pagesë

Arkivim i dokumentacionit për projekte të realizuara

Asistencë profesionale pranë drejtorive tjera në kuadër të menaxhimit të projekteve.

Takime për diskutime dhe vlerësimin e gjendjes së projekteve

### **Projektet Kapitale për vitin fiskal 2025 që do të realizohen sipas procedurave:**

- 1) Ndertimi i rrugëve lokale "Mehmet Lumi"-degëzim, "Martiret e Sukave"-degëzim, "Uniteti" ,Selim Ali Baku", "Alush Rexhepi"-degëzim, "Shkodra", "Ramadan Suka"-vazhdim, "Shtabi Ushtarak"-degëzim, "Valbona"-vazhdim "Kadri Qollaku"-degëzim dhe "Trimat"-degëzim në Bllacë .
- 2) Ndertimi i rrugës "Te Varrezat-Parajsa" në Breshanc .
- 3) Ndërtimi i rrugëve lokale "Furra e UÇK-së", "Ali Buqa" e "Sherif Buqa" në Budakovë .
- 4) Ndërtimi i rrugëve lokale "Zylfije Sopa" dhe "Qamil Kadolli" në Bukosh.
- 5) Ndërtimi i rrugës lokale "Burimi i fshatit" në Delloc.
- 6) Ndërtimi i rrugëve lokale "Izet Shefketi" dhe "Bajram Islami" në Doberdelan.
- 7) Ndërtimi i rrugëve lokale "Sherif Çatani", "Haxhi Bujari" "Kukësi"-aneks dhe "Shotë Galica" në Duhël.
- 8) Ndërtimi i rrugës lokale "Qamët"-vazhdim në Dvoran.
- 9) Ndërtimi i rrugëve lokale "Sherif Qadraku", -segment dhe "Gani Kukaj" në Gelancë
- 10) Ndërtimi i rrugëve lokale "Rahim Salihu", "Jemin Jashari", "e Safet Kica"-degëzim në Grejkoc .
- 11) Ndërtimi i rrugëve lokale "Rahim Salihu", "Jemin Jashari", "e Safet Kica"-degëzim në Grejkoc .
- 12) Ndërtimi i rrugëve lokale "Bashkimi" dhe "Esat Qarri" në Grejqevc.
- 13) Ndërtimi i rrugës lokale "Ali Zogaj" në Javor.
- 14) Rikonstruimi i rrugës kryesore në Kasterc
- 15) Ndërtimi i rrugës lokale "Shtabi i UÇK-së" faza e parë në Krushicë e Eperme.
- 16) Ndërtimi i rrugës "Iagjia e Gashëve" në Krushicë e Poshtme.
- 17) Ndërtimi i rrugëve lokale "Bashkim Kabashi" Ismet Kodra"-degëzim dhe "Dituria" në Leshan.
- 18) Ndërtimi i rrugës lokale "Afrim Buqaj"-segment në Luzhnicë.
- 19) Ndërtimi i rrugës kryesore "Hamzë Jashari" në Maqitevë.
- 20) Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Florim Gashi" e " Qamil Gashi", në Mohlan.
- 21) Ndërtimi i rrugëve lokale "Ushtari I UÇK-ës "-Aneks, "Qamil Mushtisht", "-aneks", "Bafti Shala"- 2 anekse "Isak Shala" dhe "Rugova"-aneks në Mushtisht.
- 22) Ndërtimi i rrugës lokale e "Varrezave" në Neperebisht.

- 23) Ndërtimi i rrugëve lokale "Shaqir Xheladini", "Ramiz Ajeti", -segment, "Imer Bytyqi"-segment, rruga e vorrezave në lagjen "Kadriajaj", "Brinjët e Isarit"-vazhdim, "Rasim Ramadani", "Demaj"-vazhdim, "Tahir Ademi" dhe Rasim Emrushit në Nishor .
- 24) Ndërtimi i rrugës lokale "Kroni i Nikës" në Papaz.
- 25) Ndërtimi i rrugëve lokale "Ilir Konushevci"-segment djathtas, "Ahmet Sefa" Emona , "Muhamet Krasniqi" "Jashar Shasivar Bytyqi" në Peqan .
- 26) Ndërtimi i rrugës lokale "Shaip Kolgeci" në Popolan
- 27) Ndërtimi i rrugës lokale "Mehmet Tafolli" faza e parë në Qadrak.
- 28) Ndërtimi i rrugës lokale "Te lapidari" në Reqan.
- 29) Ndërtimi i rrugës lokale " Kadri Morina" në Reshtan.
- 30) Instalimi dhe sanimi i ndriqimeve publike në Samadraxhë, Studenqan, Reshtan, Semetisht, Mushtisht, Budakovë, Reqan dhe qytet.
- 31) Ndërtimi dhe rikonstruimi i kanalizimeve në Neprebisht, Grejkoc, Bllacë, Mushtisht dhe Komunë Suharekë .
- 32) Ndërtimi i shtreterve të lumit "Toplluha" dhe rikonstruimi tyre.
- 33) Ndërtimi i trotuarëve dhe parkingjeve në Vraniq, Mushtisht, Studenqan, Grejkoc dhe në Suharekë.
- 34) Ndërtimi i urave në lumin "Toplluha", Grejkoc, Mushtisht dhe Komunë.
- 35) Blerja e paisjeve për funksionalizimin e kompanis Eko-Theranda.
- 36) Rregullimi dhe rikonstruimi i lumit "Toplluha" në Suharekë.
- 37) Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve lokale "Muhlan-Krushicë, Papaz, Budakovë Buzhalë, Studenqan, Topliqan, Terrnje, Gelanc dhe në Komunë.
- 38) Ndërtimi dhe rikonstruimi i rrugëve lokale "Milit Kryeziu", "Xhavit Bajraktari", Adem Kuqi", "Zekë Bajraktari", "Luigj Nikolla"-segment dhe "Aleksander Moisiu" në Suharekë .
- 39) Ndërtimi i rrugës lokale "Mikel Nika" në Sallagrazhdë.
- 40) Ndërtimi dhe rregullimi i varrezve në Biraq.
- 41) Ndërtimi i objektit për qëndrim ditë për pensionist në Samadraxhë.
- 42) Ndërtimi i rrugës "Gjallica", " Feim Morina"-segment, "5 Nëntori"-segment, dhe "Nexhmedin Hoti"-segment në Samadraxhë.
- 43) Ndërtimi i bunarit të Limanit mbjellja e drujve dekorativ në hapsirën e parku i dëshmorve në Samadraxhë.
- 44) Ndërtimi i rrugës lokale -Rruga UÇK-së -vazhdim në Savrovë.
- 45) Ndërtimi i rrugëve lokale "Ukë Bytyqi"-degëzim te shkolla dhe "Spitali I Luftës" në Semetisht.
- 46) Ndërtimi i rrugëve në Mohlan - Stravuqinë faza e parë.
- 47) Ndërtimi i rrugëve lokale "Eqerem Qabej", "Arsim Gegaj" dhe "Gurra" në Studenqan.
- 48) Ndërtimi i rrugëve lokale "Hil Mosi" dhe "Tafolli" në Shirokë.
- 49) Ndërtimi i rrugës "Te vorrezat"-faza e parë në Topliqan

- 50) Ndërtimi i rrugës lokale "Dajti"-vzhdim në Tërrnje.
- 51) Ndërtimi i rrugëve lokale "Ushtari i lirisë" në Vërshec.
- 52) Ndërtimi i rrugëve lokale "Firajes" dhe "Matoshve" në Vraniq.
- 53) Nërtimi i impiantit për ujra të zeza në Dubravë

**- Sektori i parandalimit të zjarrit**

Në këtë plan vjetor të punës, janë të evidentuara disa prej objekteve të cilat do të inspektohen, si dhe punë tjera të lemisë së parandalimit të zjarrit

**MUAJI JANAR**

- 1. Supermarketi VIVA Sopijë insp.fillestar..... \_\_\_\_\_
- 2. Fabrika e Pallomave Duhël.insp.fillestar..... \_\_\_\_\_
- 3. Market Restorant "Elektroni" Grejkoc insp.i rregullt..... \_\_\_\_\_
- 4. Objekti i sh.fillore "Dëshmorët e Grikocit" Grejkoc insp.i rregullt. \_\_\_\_\_
- 5. Inspektime kontrolluese..... \_\_\_\_\_

**MUAJI SHKURT**

- 1. Inspektim i lokaleve dhe kafiterive të ndryshme..... \_\_\_\_\_
- 2. HANDIKOS në Suharekë insp.fillestar i objektit..... \_\_\_\_\_
- 3. Fabrika " Termoinstal" në Shirokë insp. i rregullt..... \_\_\_\_\_
- 4. Pompa e benzines UNIK Sh.P.K. ne Suharekë insp.i rregullt..... \_\_\_\_\_
- 5. Fabrika e mishit "Jetimat e Ballkanit" Gelancë insp.fillestar..... \_\_\_\_\_

**MUAJI MARS**

- 1. Fabrika VLLESA Shirokë insp.i rregullt..... \_\_\_\_\_
- 3. Objekti tregëtar " Prima Keramika " në Shirokë insp.i rregullt..... \_\_\_\_\_
- 3. Ushtrim me personel shkollave me rastin e nje zjarri dhe evakuimin e nxënësve \_\_\_\_\_
- 4. Pruarje të Aktvendimeve..... \_\_\_\_\_
- 5. Sallone të mobiljeve Suharekë insp.te rregullta..... \_\_\_\_\_
- 6. Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve..... \_\_\_\_\_

**MUAJI PRILL**

- 1. Objekti depo e materialeve ndërtimore Shirokë..... \_\_\_\_\_

2. Objekti tregëtar "Ble Ar" Shirokë insp.i rregullt.....

3. TEB Banka Suharekë insp i rregullt.....

4.Insp.i marketeve të ndryshme në teren.....

5.Insp.i puntorive mekanike.....

#### **MUAJI MAJ**

1.Supermarketi Beni Bukosh insp.i rregullt.....

2.Salloni Mimoza Kadriaj ins. I rregullt.....

4.Pruarja e Aktvendimeve.....

5.Dalje në vendngjarje.....

6.Inspektime kontrolluese të objekteve.....

#### **MUAJI QERSHOR**

1.Fabrika e këpucëve "SOLID" Shirokë insp. i rregullt.....

2.Rreth shtabit per korrje shirje rreth parandalimit te zjarrit gjatë sezonit dhe gjendjes teknike te autokombajnave.....

3.Pranim teknik të objekteve.....

4.Dalje në teren vëzhgim mbi gjendjen në teren dhe në zonat potenciale të shpërthimit të zjarreve duke u bazuar në përvojat e viteve të kaluara.....

5.Raport gjashtëmujor.....

#### **MUAJI KORRIK**

1. Inspektim i autokombajnave dhe mjeteve tjera në teren të angazhuara për korrje shirje.....

2.Inspektime kontrolluese.....

3. Dalje në teren, biseda me banorë të fshatrave rreth zjarreve pyjore dhe dëmeve që shkaktohen nga paraqitja e zjarreve.....

4.Shpërndarje e APEL-it n-it nëpër fshatra të komunës mbi senzibilizimin e popullatës për kujdesin e vazhdueshëm në parandalimin e zjarreve.....

5.Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....

6.Raporte nga terreni për sezonin e korrje shirjes.....

**MUAI GUSHT Në pushim vjetor**

**MUAI SHTATOR**

- 1.Fabrika e mobiljeve “ Graniti” në Gjinoc insp.i rregullt.....\_\_\_\_\_
- 2.Kosova Holding Shirokë insp.i rregullt.....\_\_\_\_\_
- 3.Inspektim i lokaleve të ndryshme.....\_\_\_\_\_
- 4.Inspektime kontrolluese të objekteve.....\_\_\_\_\_
- 5.Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....\_\_\_\_\_

**MUAI TETOR**

- 1.Objekti i sh.fill.”28 Nëntori” Dobërdelan insp.i rregullt.....\_\_\_\_\_
- 2.Objekti i ombulancës në Doberdelan insp.i rregullt.....\_\_\_\_\_
- 3.Fabrika e mobiljeve Shirokë,zona industriale insp.i rregullt.....\_\_\_\_\_
- 4. Lokale dhe piceri të ndryshme.....\_\_\_\_\_

**MUAI NËNTORË**

- 1.Objekt tregtar Bau Kodra në Shirokëinsp.i rregullt.....\_\_\_\_\_
- 2.AMF Doberdelan insp.i rregullt.....\_\_\_\_\_
- 3. Pruarje te Aktvendimeve.....\_\_\_\_\_
- 4. Inspektime kontrolluese të objekteve.....\_\_\_\_\_
- 5. Dalje në vendngjarje me rastin e zjarreve.....\_\_\_\_\_

**MUAI DHJETOR**

- 1.Pompa e benzinës Lab Oil Dubravë insp.i rregullt.....\_\_\_\_\_
- 2 Depo ushqimore për shpërndarje në Shirokë insp.i rregullt.....\_\_\_\_\_
- 3. Inspektime të dyqaneve ku mbahen dhe tregëtohen mjete piroteknike\_\_\_\_\_
- 4.Raporti i punës për vitin 2025.....\_\_\_\_\_
- 5. Përpilimi i planit vjetor të punës për vitin 2026.....\_\_\_\_\_

**Spektori i njësisë së zjarrëfikësave**

## **Planifikimi i punëve në NJPZSh**

NJPZSh në Suharekë si në çdo vitë, po ashtu dhe në këtë vitë do të vazhdojë në realizimin e detyrave për çka dhe është e dedikuar. Detyra primare e këtij shërbimi është për mbrojtjen e jetës së qytetarëve, si dhe të mirat materiale të tyre nga fatkeqësit natyrore, zjarret, ndeshjet në komunikacion si dhe në intervenime të ndryshme me kërkesen e qytetarëve..

Për tju përgjegjur kërkesave të qytetarëve në çdo kohë, kjo nësi është në gjendje gadishmerie 24 orë..

Sektori i NJPZSH do të mirëbaj objektin si dhe tekniken të cilën e posedon sipas planit ditor të njësis, ku parashihet kontrollimi ditor, javor, dhe ate mujor.

NJPZSh në Therandë do ta vazhdoj bashkpunimin me: NJPZSH të Regjionit, Shërbimin Policor në Therandë si dhe me institucionet tjera.

Rregullisht do ti raportojmë Drejtorit DSHPSAE , për gjendjen në njësi , si dhe për detyrat e realizuar.

Agjencionit të Menagjimit të Emërgjencave (AME-së) në Prishtinë i raportojmë një here në muaj për intervenimet e realizuara.

Në bashkpunim me sektorin e MC pranë Drejtorisë SHPSAE planifikojmë formimin e njërive vullnetare në kuadër të sektorit të NJPZSH, si dhe të sektorit për mbrojtje civile.

Njëherit do të organizojmë ushtrim të përbashkët në nivel komunal me: NJPZSh, MC, PK, Kryqin e Kuq, si dhe me Emërgjencen

NJPZSh planifikon që një here në muaj të ket takime zyrtare me shefat e udhëheqësit e gupeve, kurse në çdo tre muaj me të gjithë puntorët e shërbimit zjarrëfikës dhe të shpëtimit.

Pos detyrave të rëndomta të cilat i ka ky shërbim, planifikojmë që ti mbajmë dhe disa ushtrime në nivel të ndërrimit, si dhe ate në nivel të njësisë.

Në nivel të ndërrimit do ti organizojmë në çdo tre muaj, kurse ate në nivel të njësis në çdo gjashtë muaj.

Ushtrimet në nivel të njësis do të tentojmë ti organizojmë në bashkpunim me NJPZSH të Regjionit.

Do të vazhdojmë me ngritjet e aftësimin profesional me kure të ndryshme, të cilët organizohen në niveltë të AME-së

NJPZSh në Therandë gjatë viti 2025 planifikon që planin dhe programin e punës ta realizon me sukses sikurse dhe viteve të tjera.

## **PLAN PROGRAMI I PUNËS**

NJPZSH në Therandë ka planifikuar orarin teorik dhe ate praktik të punës i cili është i ndarë në palin ditor, javor, dhe mujor.

## **PLANI DITOR I PUNËS**

Sajë përket planit ditor kryerja e punëve fillon sipas rendit të ditës që me pranimin – dorzimin e detyrës, kontrollimi ditor i paisjeve të njësis.

## **PLANI JAVOR I PUNËS**

Plani i kontrollimit javor përfshin : paisjet dhe aparatet për shuarjen e zjarrit, si dhe të automjeteve

### **Plani vjetor**

#### **JANAR**

1. Analiza e punës e vitit të kalum
2. Djegëja -Teori dhe Praktik
3. Produktet nga Djegëja
4. Shuarja e zjarreve
5. Njohuritë themeleore për shkaktarët e zjarreve dhe mbrojtja nga zjarre

#### **SHKURT**

1. Shkaktaret e zjarreve-teori
2. Mbrojtja nga zjarret në objekte ndertimi-teori dhe praktik

#### **MARS**

1. Taktika e shuarjes së zjarreve- teori dhe praktik
2. Materjet të lëngëta qe ndizen leht-teori
3. Ç,ka është zjarri dhe klasifikimi i zjarreve -teori
4. Teori dhe praktik për Aksidente Rrugore

#### **PRILL**

1. Shpëtimi i njerzve ,Shpëtimi i pasurisë, udhëheqja e aksionit gjatë intervenimit
2. Shuarja e zjarreve ne teren të hapur
3. Shpëtimi i njerzve me litar-teori
- 4 Shpëtimi I njerzve me litar -praktik
5. Ushtrime me aparat të frymarrjes –praktik
6. Menyra e shurjes së zjarreve në ambientin e mbyllur dhe nxjerrja e viktimave .

#### **MAJ**

1. Shpëtimi i njerzve nëper objekte shkollore
2. Ushtrime me shkallë
3. Ushtrime për aksidente rrugore
4. Ndhima e pare-teori
5. Ndhima e pare praktik

### **QERSHOR**

1. Trajnimi me litar-shpëtimi i jetrave te njerzve
2. Ushtrime me aparat të frymarrjes

### **KORRIK**

1. Ngritja e nivelit të gadishmërisë, gjatë sezonit veror, zjarre fushore dhe malore

### **GUSHT**

1. Gjendje gadishmerie për zjarre te ndryshme dhe për aksidente

### **SHTATOR**

1. Teknika për zjarrfikje-paisje personale dhe mjetet te perbashkëta
2. Ushtrime me shkallë mekanike

### **TETOR**

1. Ushtrim në shkoll për shpëtimin e nxënësve dhe përsoneleit të shllollës në raste të dryshme si: zjarrit, termetir apo helmimeve, në bashkpunim me MC

### **NËNTOR**

1. Ushtrime praktike ne kushte te veshtira klimatike
2. Shuarja e zjarreve me shkum
3. Shuarja e zjarreve me pluhur
4. Mirmbajtja e pompave të zjarrfiksav
5. Mirmbajtja e automjeteve për sezonin dimror dhe pregaditja

### **DHJETOR**

1. Pregaditja për sezonën dimrore
2. Mirmbajtja e automjeteve për sezonin dimror
3. Vlersimet e puntorve për punën e vitit 2024
4. Plani për vitin 2025

### **PRIORITETET PËR VITIN 2025**

1. Plotësim me staf (Pranimin e zjarrfiksive të ri)
2. Thurrja e objektit
3. Ngritjen e garazhave për automjete
4. Të shikohet mundësia e ngritjes së objektit të ri për nevojat e NjPZSh

## DREJTORIA PËR KULTURË RINI SPORTË DHE MËRGATË

### **Objektivat zhvillimore në sektori e kulturës për vitin 2025**

1. Ndërtimi i ri, përmirësimi dhe zgjerimi infrastrukturës kulturore
2. Zhvillimi i aktiviteteve kulturore
3. Formimi i institucioneve të reja kulturore
4. Zhvillimi i kulturës dhe aktiviteteve kulturore në zonat rurale.
5. Përkrahja financiare dhe bashkëpunimi me OJQ, SHKA dhe organizatat tjera kulturore.
6. Aftësimi profesional kuadrove
7. Bashkëpunimi kulturorë me diasporën dhe qytetet partnere jashtë vendit
8. Formimi i komisioneve konsultative për fushat e ndryshme të kulturës  
Formimi i fondacionit për Kulturë

Qëllimi (çka dëshirojmë të arrihet)	Veprimi/Aksioni (cilat janë veprimet për t'i përmbushur objektivat)	Afati kohor për përfundimin/përmbushjen e aktivitetit	Kostoja financiare	Përgjegjësia (kush e bënë realizimin/ implementimin)	Rezultat et e pritura	Vështirësitë/ Sfidat (buxheti adm. personeli)
--	--	---	-----------------------	---	--------------------------	--

#### **Investimet Kapitale**

Inventarizimi i shtëpisë së Kulturës	Paisja me Kompjuter, Printer Tavolina të punës Paisja e skenës me ndriqim dhe zërim profesional Paisja e dhomës së Baletit me pasqyre	Koha e implementimit: Janar-Dhjetor 2025	100,000 €	Operatori ekonomik që fiton tenderin	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat, [ OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj.
--------------------------------------	--	---	-----------	--------------------------------------	---	--

	Paisja e dhomave përgatitore mbrapa skenës					
--	--	--	--	--	--	--

### Manifestimet Festive dhe përkujtimore:

Zhvillimi i aktiviteteve rinore, kulturore sportive, humane , ekologjike dhe ruajtja e Traditës	Organizimi i Festarit 2025 Formimi i këshillit organizativ Formimi i grupeve punuese dhe përgatitjet teknike për realizimin e projektit.	Koha e implementimit : 22-27 Shtator	Bugjeti: 27.000€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , [ OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj.
Zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe bashkëpunimi me Diasporën	Organizimi i festës së diasporës “Diafest”	Koha e Implementimit Korrik - Gusht	7000€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj
Kremtimi i ditës se Pavarësisë	Realizimi i programit artistik për ditën e pavarësisë dhe aktiviteteve tjera	Koha e implementimit : 17 shkurt	Bugjeti: 5000 €	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donator: KK. etj. Biznesi Privat
Kremtimi i ditës se Çlirimit	Realizimi i programit artistik për ditën e Çlirimit	Koha e implementimit : 13 Qershor	Bugjeti: 10.000 €	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donator: KK. etj. Biznesi Privat
Zhvillimi i turizmit Kulturor	Karnevali Red eagle	Koha e implementimit : Maj	Sponsori zim jo monetar infrastrukturë	Kompania Fruteks Komuna – DKRSM Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donator: . Biznesi Privat Frutex
Kremtimi i ditës se flamurit Kombëtar	Organizimi i aktiviteteve artistike për akademinë solemne 28 nëntori dita e flamurit:	Koha e implementimit: 27 Nëntor,	Bugjeti 2,000€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donator: KK. etj. Biznesi Privat
Përkujtimet të viktimit të luftës:	Organizimi i aktiviteteve artistike për akademinë përkujtimore 26 marsi dita e përkujtimet të viktimit të luftës:	Koha e implementimit: 26 mars	Bugjeti 1500€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës se planifikuar	Donator: KK. etj. Biznesi Privat

Përkujtimi – ndarja e Çmimit Ukë Bytyçi	Organizimi i aktiviteteve artistike për akademinë përkujtimore të Ukë Bytyçit:	Koha e implementimit: 27 tetor	Bugjeti 1500€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donator: KK. etj.
Përkujtimi i kryetarit historik të Kosovës Dr. Ibrahim Rugova	Organizimi i aktiviteteve artistike për Mbrëmjen artistike kushtuar veprimtarisë letrare dhe politike të presidenti Rugova	Koha e implementimit: 21 Janar	Bugjeti 1000€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donator: KK. etj.

### Aktivitetet Kulturore:

#### Aktivitetet muzikore:

Organizimi i festivalit të solistëve nga komuna jonë:	Organizimi i festivalit, Formimi i Jurisë vlerësuese, Orkestrës Muzikore mbajtja e audicionit dhe programit artistik për finale, ndarja e çmimeve, skenografia ndriçimi etj.	Koha e implementimit : Maj Qershor	Bugjeti: 10,000€	Komuna – DKRS Shoqëria Civile Dhe Komuniteti i Biznesit	Te mira, sipas dinamikës së planifikuar	Donatorë: KK, MKSR, Biznesi Privat , OJQ-ve, vendore dhe ndërkombëtare etj.
